

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Prizreni ka nevojë për më shumë aktivizëm kulturor

30 maj 2014, Prizren

Në mbrëmjen e 29 majit 2014 (e enjte) në Prizren u diskutua për potencialin e aktivizmit kulturor në qytet. Në forumin e diskutimit **"Festivalet si formë e aktivizmit kulturor"** organizuar nga EC Ma Ndryshe, folën Eroll Bilibani nga Dokufest, Leotrim Fishekçiu nga Sculp Fest dhe Xhevdet Doda nga komuniteti artistik, ndërsa ai u moderua nga Fisnik Minci, gazetar i Koha Ditore. Gjatë forumit, panellistët dhe pjesëmarrësit diskutuan mbi ngjarjet kulturore të Prizrenit dhe potencialin e tyre për të ndikuar mbi politikën lokale dhe promovuar aktivizmin kulturor dhe urban në qytet.

Njëri ndër konstatimet kryesore të diskutimit ishte që Prizreni është qytet i pasur me aktivitete kulturore, por me aktivizëm të kufizuar kulturor. Panelistët reflektuan mbi përvojat e tyre në organizimin e festivaleve, duke i potencuar vështirësitë në edukimin e gjeneratave të reja të aktivistëve të kulturës. Pjesëmarrësit e diskutimit i rikonfirmuan pengesat e natyrave të ndryshme, të cilat e pengojnë zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Mbi të gjitha, mungesa e një vizioni të qeverisë lokale për zhvillimin kulturor të qytetit dhe dëmtimi i strukturës urbane nga grupet e caktuara të interesit, u vlerësuan si pengesat kryesore për zhvillimin e qytetit. Ky forum i diskutimit prodhoi disa rekomandime, ndër të cilët: forcimi i rrjetëzimit të komunitetit të kulturës për të shtyrë përpara agjendën kulturore të qytetit, shfrytëzimi i organizimeve kulturore për të nxitur aktivizmin, organizimi i performancave artistike në hapësirën publike, mobilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit dhe forcimi i kapacitetit avokues për nxitjen e politikave kulturore lokale.

Forumi i diskutimit "Festivalet si formë e aktivizmit kulturor" është i pari në ciklin e pesë forumeve të diskutimit që do të organizohen në baza mujore në Prizren. Këto forume janë pjesë e projektit "Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren", i cili synon të nxisë debat shoqëror mbi rolin e aktivizmit kulturor në transformimin urban të qytetit. Në esencë, projekti është një nismë e intervenimit kulturor dhe artistik që synon t'i trajtojë në mënyrë kreative sfidat e zhvillimit urban dhe reformës demokratike në Prizren. Përveç forumeve të diskutimit, gjatë vitit 2014 pjesë e këtij projekti do të jenë edhe këto aktivitete: hulumtimi mbi potencialin e aktivizmit kulturor dhe urban në Prizren, intervenimet artistike në hapësirën publike, platforma virtuale për blogging kulturor dhe konferenca rajonale për shkëmbimin e përvojave mes aktivistëve kulturor nga shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ju falemnderit.

Me respekt,  
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Perandori Dioklician 14 (kati V) Prishtinë & Saraçët 5, 20000/Prizren  
038 224 967 & 029 222 771  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

*"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."*

